



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada – Government**

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike  
Ministarstvo Ekonomije, Zapošlavanja, Trgovine, Industrije, Preduzetništva i Strateških Investicija  
Ministry of Economy, Employment, Trade, Industry, Entrepreneurship and Strategic Investments

Datë 28.05.2020

## **Vlerësimi i zbatimit të masës reciproke ndaj Serbisë**

### **Zbatimi i vendimit të datës 31 mars 2020**

Raporti paraqet të dhënat mbi zbatimin e vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 31 mars 2020 mbi masën reciproke ndaj Serbisë dhe mbulon periudhën 1 prill-27 maj 2020. Raporti është i ndarë në dy indikatorët të cilët janë subjekt i vendimit të datës 31 mars dhe indikatorë të tjerë të vlerësuar të rëndësishëm nga institucionet relevante, të shoqëruar me anekse. Në fund, aneksi përmban tabelën me mallrat e importuara dhe eksportuara në Serbi dhe nga Serbia për këtë periudhë.

Sipas vendimit në fjalë në marrëdhëniet tregtare me Serbinë, emërtimet e përdorura në dokumentet si në vijim duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi:

1. Certifikata fitosanitare dhe dokumentacioni shoqërues për produktet ushqimore dhe jo ushqimore me prejardhje bimore dhe joshtazore që i nënshtrohen kontrollit fito sanitar në kufi;
2. Certifikata veterinare dhe dokumentacioni shoqërues për produktet ushqimore dhe jo ushqimore me prejardhje shtazore që i nënshtrohen kontrollit veterinar në kufi.

Për të monitoruar zbatimin e këtyre masave te reciprocitetit, më datën 22 prill 2020, Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, ka themeluar me vendim grupin ndërinstitucional për monitorimin e zbatimit të masave të reciprocitetit të vendosur ndaj Serbisë, grup i cili kryesohet nga u.d. sekretari i përgjithshëm i MEPTINIS me anëtarësim nga: drejtoritë përkatëse brenda MEPTINIS, Dogana, AVUK dhe Policia Kufitare. Grupi Nderinstitucional ka vlerësuar dhe analizuar zbatimin e masave të

reciprocitetit dhe ka sjellë këtë draft raport për shqyrtim nga kabineti i Ministres për Ekonomi, Punësim, Tregti Industri, Ndërmarrësisë dhe Investime Strategjike.

## Raporti

Lidhur me dy indikatorët e lartpërmendur, respektivisht dy masat që janë subjekt i reciprocitetit, nga të dhënat e Doganës së Republikës së Kosovës del se në periudhën 1 deri 21 prill janë kthyer gjithsej dy (2) kamionë të cilët kanë pasur destinim Kosovën. Njëri kamion është kthyer për shkak të emërimit jo të duhur të Kosovës (APKiM dhe 1244) ndërsa kamioni tjetër për shkak të skadimit të regjistrimit të rimorkios. Ndërsa, në periudhën 21 Prill-27 Maj ka pasur një kthim të kamionit me produktin e fasules me origjinë nga Kirgistani, pasi që emërtimi në dokument i shtetit të Kosovës nuk ka qenë në përputhje me termat kushtetues.

Po ashtu pas marrjes së vendimit për reciprocitet kishte ndodhur edhe një diskriminim tjetër nga ana e institucionit të doganës së Serbisë, e cila ka sjellë një vendim te ri ku ka potencuar që për arsye që është kthyer malli për dokumente jovalide nga fitosanitari, mauna në fjalë duhet të del nga territori i Serbisë në afat prej 48 orëve në të kundërtën e gjithë dërgesa do të konfiskohet nga dogana serbe. Mauna në fjalë është detyruar që të kthehet përsëri në Prishtinë për zhdoganim në Republikën e Kosovës, pasi që nuk është mbajtur përgjegjësi nga asnjëra palë as nga dogana serbe dhe as nga fitosanitari, dhe po ashtu edhe importuesi në Serbi ka deklaruar se këto janë vendime të shtetit të Serbisë dhe nuk mund që ti kundërvihet shtetit të tyre.

Dhe së fundmi me datë 01.05.2020 një kompani Kosovare ka pasur një dërgesë, riekспорт nga Kosova për në Serbi ku produkti është importuar në Kosovë nga Turqia, por pas një marrëveshje me një klient të kompanisë Kosovare në Serbi është vendosur që malli si destinim përfundimtar ta ketë Serbinë. Kompania ka përgatitur të gjithë dokumentacionin përkatës sipas standardeve ndërkombëtare në marrëveshje me kompaninë importuese serbe ku edhe është marrë aprovimi nga inspektori fitosanitar Serb në PK në Preshevë se dokumentacioni përcjellës është në rregull. Në momentin që mauna ka arritur në kufi në PK në Preshevë sipas inspektorit fitosanitar Serb dokumentacioni i kompanisë është refuzuar si jo valid pasi që është theksuar Republika e Kosovës dhe nuk është në përputhje me ligjin e Serbisë për ushqim gjegjësisht neni 71 i ligjit 41/09 dhe 17/19. Mauna është detyruar që të kthehet përsëri në Kosovë për zhdoganim, pasi që nuk është mbajtur përgjegjësi nga asnjëra pale, as nga dogana serbe dhe as nga fitosanitari.

Mirëpo pas këtij rasti ka pas edhe dy eksporte për tregun Serb të cilat janë eksportuar dhe lejuar të futen në tregun Serb, me datën 04.05.2020. 18 ton fruta të ngrirë (dredhëza) dhe 15 ton boronicë organike.

Për detajet teknike të formës së lëshimit të dy certifikatave nga autoritetet Serbe shih aneksin nr. 1, kopja e certifikatës veterinare të lëshuar nga autoritetet serbe, e datës 24.04.2020 dhe kopja e certifikatës fitosanitare e lëshuar nga autoritetet Serbe e datës 01.04.2020.

Në periudhën 1-30 prill 2020 janë importuar mbi 15 milion euro nga Serbia ndërsa janë eksportuar nga Kosova në Serbi mbi 1 milion euro. Në periudhën 1-27 Maj 2020 janë importuar mbi 15 milion euro nga Serbia ndërsa janë eksportuar nga Kosova në Serbi rreth 2 milion euro.

Produktet që më së shumti janë importuar janë: dema dhe mēzate, grurē, ushqime tē tjera pēr kafshē. Ndērsa, produktet që më së shumti janë eksportuar ishin: linjiti, paleta prej druri, mana. Shih aneksin 4 pēr shkēmbimet tregtare me Serbinē, periudha 01.04-30.04.2020 dhe 01.05-27.05.2020.

Ndērsa ekziston dyshimi që certifikatat që lēshohen pēr Kosovē janē tē formatit tjetēr me ato që lēshohen pēr shtetet tjera.

### **Rekomandim 1**

#### **Opsion 1:**

Status quo, tē lihet nē fuqi vendimi i datēs 30.03.2020, pēr dy certifikatat. Tē vēzhgohet reagimi i Serbisē pas disa ndryshimeve nē certifikatat që lēshohen nga AUVK, duke shtuar termin Kosovē.

#### **Opsion 2:**

Qeveria tē anulon masēn e reciprocitetit pēr kēto dy certifikata, shfuqizon vendimin e datēs 31.03.2020, meqē tanimē AUVK e ka tē qartē se çka duhet tē kērkohet dhe e ka obligim tē kērkon kēto elemente nē vazhdimēsī.

## **Certifikatat që lēshohen nga AUVK**

Njē qēshtje tjetēr ka tē bēj me certifikatat që lēshon AUVK ku mund tē vērēhet që emērtimi i certifikatēs fitosanitare i lēshuar nga AUVK nē marrēdhēniet tregtare me Serbinē ēshtē vetēm “Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisē”, pra nuk specifikohet emri “Kosovē”. Shih aneksin nr. 3. kopje e certifikatēs fitosanitare e lēshuar nga AUVK.

### **Rekomandim 2**

Rekomandohet AUVK që pēr tē gjitha certifikatat sanitare dhe veterinare që lēshohen nē raport me Serbinē, nē kētē rast edhe pēr shtetet tjera tē figurojē emri i shtetit tē Kosovēs tek emri i agjencisē, pra “Agjencia e Ushqimit dhe Veterinēs e Republikēs sē Kosovēs“ ose “Agjencia e Ushqimit dhe Veterinēs e Kosovēs”, si dhe tek pjesa ku lēshohēn certifikatat fitosanitare dhe veterinare tē jetē si nē vijim: emri i qytetit / emri i vendit, p.sh. Prishtinē / Kosovē.

## **Pērdorimin e shenjēs XK dhe XS**

Lidhur me diskutimin që u bē nē takimin e datēs 30 Prill tē grupit ndērinstitucional pēr monitorimin e zbatimit tē reciprocitetit lidhur me terminologjinē “XK”, nga pērfaqēsuesi i Doganēs u theksua se marrēdhēniet tregtare tē Kosovēs me BE-nē janē specifikuar me Rregulloren e Kēshillit 2007/2000 tē Shtatorit tē vitit 2000. Kjo Rregullore e njeh Kosovēn si njē territor unik doganor dhe prodhimet e Kosovēs janē pērjashtuar nga tarifatat doganore. Kosova ka pērfituar nga Masat Autonome Tregtare tē BE-sē, tē cilat kanë mundēsuar eksportin e produkteve tē Kosovēs nē BE. Mirēpo, nē marrēdhēniet tregtare tē Kosovēs me BE-nē referuar rregullores sē Kēshillit 2007/2000 tē Shtatorit tē vitit 2000, nē asnjē pikē nuk gjendet terminologjia “XK”, pēr tē cilēn u diskutua nē takim. Sipas disa kērkimeve tē thjeshta nē Google del se “XK” derivon si terminologji e pērkohshme nē kuadēr tē UN 1244 (<https://ēēē.cia.gov/library/publications/the->

[world-factbook/geos/print\\_kv.html](http://world-factbook/geos/print_kv.html)). Siç dihet tashmë në fuqi nga viti 2016 është MSA që rregullon marrëdhëniet tregtare në mes të Kosovës dhe BE-së. Sipas disa certifikatave doganore mund të vërehet që Serbia nuk heziton që në këto certifikata të përdorë terminologjinë “XK”. Megjithatë, ka raste ku mjaft shpesh Serbia përdor edhe termin “Kosovo”, mirëpo ka edhe raste kur i referohet vetëm me “XK” dhe emri i qytetit (kjo mund të vërehet në dokumentacionin e pranuar nga Dogana me datë 29 Prill 2020). Shqetësimi i ngritur në takim me datë 30 Prill ishte që ka raste të evidentuara kur certifikata ka terminologjinë “XK” vetëm me emër të qytetit të Kosovës dhe nuk është i shënuar emri i plotë i Kosovës. Prandaj, në takim u kërkua që të shihet mundësia por gjithmonë pa dëmtuar relacionet me partnerët tregtarë dhe në respektim të plotë me obligimet ndërkombëtare që ka ndërmarrë Kosova, që mos të pranohen certifikatat e tilla kur emri i Kosovës nuk prezantohet por prezantohet vetëm emri i qytetit të Kosovës, p.sh, Gjilan, XK konsiderohet se nuk do të duhej të jetë por do të duhej të jetë Kosovo, XK ose vetëm Kosovo së bashku me emrin e qytetit (Gjilan, Kosovo). Vlen të theksohet se “XK” gjendet edhe në MSA, por që është e nënshkruar nga Kosova sipas marrëveshjes së Brukselit. Poashtu, siç e përdorë Kosova “XK” të njëjtin kod e përdorë edhe Serbia si “XS”. Shih aneksin 4 dokumentin doganor për ilustrim.

### **Rekomandim 3**

Rekomandohet Ministria e Financave dhe Transfereve/Dogana e Kosovës që në marrëdhëniet tregtare me Serbinë, të mos njohin dokumentacione të lëshuara nga autoritetet Doganore Serbe duke ju drejtuar Kosovës me mbishkrimin XK dhe emrin e qytetit, nëse nuk përmendet Kosova. Të pranohen vetëm alternativat në mënyre reciproke si: Serbia–Kosovo apo Republic of Serbia – Republic of Kosovo.

## **Barrierat tjera tregtare që nuk hyjn në domenin e vendimit të reciprocitetit**

- Me datën 21.04.2020 në Pikat e Kalimit Kufitar me Republikën e Serbisë, si pasojë e një vendimi të lëshuar nga autoritetet serbe janë ndaluar përkohësisht qarkullimi (hyrja) në Serbi i kamionëve duke përfshirë edhe kamionët me targa RKS dhe KS. Kjo çështje është zgjidhur tashmë.
- Bazuar në informatat e pranuar nga Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit (QKMK), gjatë kësaj periudhe raportuese ne kemi pranuar informacionet se pala serbe në mënyrë sporadike nuk ka lejuar kalimin e maunave me mallra apo edhe atyre të zbrazët përmes PKK-ve në Merdarë, Jarinje dhe Bërnjak.
- Sipas informacioneve të marra nga terreni nga PKK-të, kemi marrë informacionet se pala serbe kthimin e transportuesve e arsyeton se ata duhet të parashtrajnë kërkesa pranë Zyrës Ndërlidhëse të Serbisë në Kosovë, për të hyrë në territorin e Serbisë dhe kërkesa të dërgohet përmes emailit [teretnitransports@gmail.com](mailto:teretnitransports@gmail.com).
- Vlen të potencohet se pala serbe nga data 21.04.2020 ka filluar të ndërmarrë këto veprime. Fillimisht, duke mos lejuar hyrjen e maunave me regjistrim të Kosovës (KS dhe RKS) dhe pastaj më vonë ka lejuar hyrjen e tyre.

- Gjersa rastet e kthimit të transportuesve nga pala serbe në PKK ende vazhdojnë për maunat me regjistrim të Serbisë dhe maunave me regjistrim të vendeve të tjera të cilat duan të dalin nga Kosova. Të gjitha këto veprime pala serbe i lidhë me arsyetimin e lartcekur se për të hyrë në territorin e Serbisë duhet kërkesa të dërgohet përmes emailit [teretnitransports@gmail.com](mailto:teretnitransports@gmail.com).
- Për rastin në fjalë grupi punues për monitorimin e masës së reciprocitetit ka reaguar tek autoritetet si: CEFTA, Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC), Zyra e BE-së në Prishtinë dhe Komisioni Evropian në Bruksel.
- Marrëveshja për IBM (3 dhjetor 2011) dhe Protokoli Teknik për IBM (23 shkurt 2012) paraqesin marrëveshjen e parë e nënshkruar ndërmjet dy vendeve, që ka mundësuar rivendosjen e autoriteteve shtetërore Kosovare në dy pikë-kalime kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak. Sa i takon Marrëveshjes së IBM (MIK), përkatësisht për ndërtimin e objekteve të përhershme të MIK, Kosova ka bërë përparim të jashtëzakonshëm në përfundimin e dizajnit final të projekteve në bashkëpunim me BE-në dhe UNOPS-in si partner implementues për ndërtimin e tyre. Marrëveshjet parashohin ndërtimin e 6 pikave të kalimit të përhershëm, me përkrahje të fondeve të BE-së; 3 pika kalime kufitare në territorin e Kosovës - Merdare, Mutivoda dhe Bërnjak dhe 3 në territorin e Serbisë – Jarinjë, Dheu i Bardhë dhe Muçibabë.
- Ndërsa sa i përket zbatimi të vulave doganore Dogana e Kosovës pohon se në këtë periudhë raportuese nuk është prezantuar tek ne ndonjë informacion se pala serbe ka kthyer maunat për shkak të vulave doganore të Doganës së Kosovës.

## Shenja kombëtare e konformitetit të Serbisë e vendosur në produktet e importuara në Kosovë

Për Republikën e Kosovës është e pranueshme shenja e konformitetit "CE" e Bashkimit Evropian dhe dokumentet përkatëse të konformitetit të lëshuara nga trupa për vlerësim të konformitetit të akredituar sipas standardeve përkatëse.

Kurse dokumentet përkatëse dhe shenja e tjera të huaja të konformitetit, do të jenë të pranueshme në Republikën e Kosovës, vetëm nëse për të njëjtat ka marrëveshje ndërkombëtare të lidhur nga Republika e Kosovës.

Pas kalimit të gjendjes emergjente dhe rihapjes së objekteve tregtare, inspektorati i tregut i MEPTINIS do të ndërmerr veprime ligjore në gjitha rastet kur nuk respektohen ligjet dhe aktet e lartë cekura, si dhe ligjet e tjera të cilat i mbikëqyrë inspektorati i tregut.

### **Rekomandim 4**

Rekomandohet që të ketë kontrole më të shpeshta nga Inspektorati i Tregut i MEPTINIS dhe brenda muajit të identifikohen dhe largohen nga tregu rastet në marrëdhëniet tregtare me Serbinë, të cilat nuk janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura nga Republika e Kosovës.




Модел ветеринарског здравственог уверења за поднамену хране за извозање намирница за отпоруку  
 Model of veterinary health certificate for foodstuff intended for dispatch  
 Model i certifikatës veterinare për ushqim të kafshëve / dedikuar për

KS-31


106449

<p>1. Poшиљалац (пуно име и адреса):/ Consignor (full name and address):                  Džerzet Co. Doo                  Nišicevo, Vlasov Ostružnik 11</p>	<p>ВЕТЕРИНАРСКО ЗДРАВСТВЕНИ                  СЕРТИФИКАТ                  за храну за животиње намењену за испоруку                  на Косово                  VETERINARY HEALTH CERTIFICATE                  for foodstuff intended for dispatch to the Kosovo                  CERTIFIKATE SHENDETESORE VETERINARE                  për ushqim të kafshëve i dedikuar për në Kosovë</p>
<p>2. Прималац (пуно име и адреса):/ Consignee (full name and address):                  MARRËSI I DËRGESËS (Emri i plotë dhe adresa):                  AGROJANOV I N. SH.                  KOMPANIE GLOGOVAE, KOSOVO</p>	<p>Референтни број (1)                  ОРГИНАЛ                  Reference number (1)                  ORIGINAL                  Numri referent (1)                  ORIGINAL                  220-223-1357/2020-05/8</p>
<p>3. Порекло хране за животиње:/ Origin of the foodstuff/                  Origjina e ushqimit të kafshëve:</p>	<p>4. Надлежни орган/ Competent Authority/                  Autoritet kompetent: МИНИСТАРСТВО                  ПОЉОПРИВРЕДЕ, ШУМАРСТВА И                  ВОДОПРИВРЕДЕ, Управа за ветерину,                  Београд                  4.1 Сертификационо одљење/ Certifying                  department/ Departamenti certifikues:                  REP. VET. INSPEKCIJA</p>
<p>3.1 Место/ Place/ Vendi:                  NIŠICEVO</p>	<p>5. Одредите храну за животиње/ Destination of foodstuff/ Destinimi i ushqimit për kafshë:                  5.1 Назив и адреса одређишта/ Name and address of the destination/ Emri dhe adresa e destinimit:                  AGROJANOV I N. SH. KOMPANIE GLOGOVAE, KOSOVO</p>
<p>6. Препознато средство и идентификација поштомље (2):/                  Means of transport and consignment identification (2):/                  Mjetet e transportit dhe identifikimi i ngarkesës (2):</p>	<p>6.4 Начин паковања/ Nature of packing/                  Natura e pakimit:                  NA POK. VROZE</p>
<p>6.1 (камион, вознички вагон, брод или авион):/ (lorry, rail-                  wagon, ship or aircraft):/ (Kamion, vagon hekurudhor, anije apo                  aeroplan):                  KAMION</p>	<p>6.5 Број пакета/ Number of packages/ Numri i                  paketimeve:                  1 220 KOM.</p>
<p>6.2 Број пломбе (ако је применљиво)/ Number of seal (if                  applicable)/ Numri i vithës (nëse aplikohet):                  Duzina vithë</p>	<p>6.6 Нето маса/ Net weight/ Peshë neto:                  22 230 KG</p>
<p>6.3 Матични број (с) на возила, број вагона, назив брода, број                  лета (2):/ Registration number(s) of the lorry, number of the wagon,                  name of the ship, flight number (2):/ Numri (rat) e regjistrimit të                  kamionit, numri i vagonit hekurudhor, emri i anijes, numri i                  fluturimit (2):                  G54 KS 077/AD 003 KG</p>	<p>6.7 Референтни број произведене партије/                  Lot/ batch production reference number/                  Numri referent i prodhimit/sasleë                  /pakimit:                  20200425, 20200423</p>

Aneksi 2, kopja e certifikatës fitosanitare e lëshuar nga autoritetet Serbe

1. Назив и адреса извозника/Name and address of exporter <b>Biljni lekar doo, Boška Vrebalova 15, Veliko Gradište</b>		2. ФИТОСАНИТАРНИ СЕРТИФИКАТ/PHYTOSANITARY CERTIFICATE Број/No. <b>270- 321-3-111/2020-11</b>	
3. Пријављени назив и адреса примаоца/Declared name and address of consignee <b>Euro Coop D.T.P. Vitina, Kosovo</b>		4. Служба за заштиту биља Републике Србије Plant Protection Organization of the Republic of Serbia  Служба за заштиту биља Косова Plant Protection Organization of Kosovo	
6. Пријављено средство превоза/Declared means of conveyance <b>Kamion ČA 085 AT/AD 005 ČA</b>		5 Место порекла/Place of origin <b>Srednjevo, Veliko Gradište (Srbija)</b>	
7. Пријављено место уласка/Declared point of entry <b>Rudnica</b>			
8. Карактеристичне ознаке: Број и опис паковања, назив производа и ботанички назив биља/Distinguishing marks: number and description of packages; name of produce and botanical name of plants <b>Merhantilna pščenica (Triticum sp.) 24780kg</b> <b>Rinfuz</b>		9. Пријављена количина/Quantity declared <b>Netto 24780kg</b> <b>Btto 24780 kg</b>	
10. Осим се потврђује да су биљке или биљни производи горе описани: -This is to certify that the plants or plant products described above: -прегледани у складу са одговарајућим поступцима, и -have been inspected according to appropriate procedures, and -сматрају се слободни од карантинских штетних организама и практично слободни од других штетних организама, -are considered to be free from the quarantine pests, and practically free from other injurious pests and -сматра се да одговарају важећим фитосанитарним прописима -are considered to conform with the current phytosanitary regulations			
11. Допунска изјава/Additional declaration			
12. Поступак дезинфекције и/или дезинсекције Disinfestation and/or disinfection treatment		18 Место издавања/ Place of issue <b>Požarevac</b>	
13. Средство (активна атергија) Chemical (Active ingredient)		14. Трајање и температура Duration and temperature	
15. Концентрација/Concentration		16. Датум/Date	
17. Допунска информација/ Additional information		19. Место издавања/ Place of issue <b>Požarevac</b> Датум/ Date: <b>01.04.2020</b> Име и потпис овлашћеног лица / Name and signature of authorized officer <b>Nenad Milojević, dipl.inž.</b> Печат организације (Stamp of organization) 	

Aneksi 3: kopja e certifikatës fitosanitare e lëshuar nga AUVK

1. Name and Address of the Exporter ALEA COMPANY SH.P.K. - ZONA INDUSTRIALE NR.18, Prishtinë		AGJENCIA E USHIQIMIT DHE VETERINARISË AGENCIJA HRANE I VETERINE FOOD AND VETERINARY AGENCY PHYTOSANITARY CERTIFICATE FOR RE-EXPORT  NO: PHCRE00107/2020	
3. Declared Name and address of consignee: RAJDEL FRUIT COM DOO SVETOG SAVE 86 D SURCIN BEOGRAD		4. Plant protection organisation of Kosovo to plant protection organisation(s) of: Serbi	
		5. Place of origin: Turqi	
6. Declared means of conveyance: 671 KS 282 / 635 KS 595		PHYSIOSANITARY INSPECTION SERVICES OF KOSOVO FVA-PRISHTINA	
7. Declared Point of Entry: HANI ELEZIT			
8. Distinguishing marks: number of packages: name of the product: botanical name of the plants  Portokaj te freskete/ fresh orange valencia/ Citrus sinensis ; 2500 box		9. Quantity Declared:  22500 Kg	
10. This is to certify that the plants or plant products described above were imported into Kosovo (Country of Export) From <u>Turqi</u> covered by Phytosanitary Certificate no. -that they are <u>Original</u> Certified true copy if wich is attached to the Certificate -that they are <u>packed</u> Repacked in <u>original</u> new containers -that based on the <u>original</u> phytosanitary certificate and <u>additional</u> inspection, they are considered to nonform with the current regulations.			
11. Additional declaration:			
DIZINFESTATION AND/OR DIZINFESTATION TREATMENT		18. Place of issue Regjioni i Prishtinës	
12. Treatment		Date 01/05/2020	
13. Chemical (active ingredient):	14. Duration and temperature	Naim Delijaj Name and signature of inspector 	
15. Concentration:	16. Date 01/05/2020		
17. Additional information Fatura nr. REEX-02-2020			



Aneksi 4: Dokumenti doganor

1 Primerak za pošiljaoca  
Exemplaire de l'expéditeur

1 Pošiljaoc (ime, adresa, zemlja) Expéditeur (nom, adresse, pays)		1 a) Zemlja:		<b>MEĐUNARODNI TOVARNI LIST</b> <b>LETTRE DE VOITURE INTERNATIONALE</b> <b>CMR 0437364</b>			
2 Primaoca (ime, adresa, zemlja) Destinataire (nom, adresse, pays)		2 a) Zemlja:		16 Prevoznik (ime, adresa, zemlja) Transporteur (nom, adresse, pays)		16 a) Broj registracije prevoznika	
3 Mesto isporuke (presto, zemlja, datum) Lieu de prise en charge de la marchandise (lieu, pays, date)		3 a) Ime države		17 Česti broj vozila (ima, serija, zemlja) Numéros fréquents (nom, adresse, pays)			
4 Posiljatelj datan proizvodnja podlje na zakon (mesto, zemlja) L'expéditeur de ce produit en charge de la marchandise (lieu, pays)		4 a) Ime države		18 Priloge i opremljenje u vozilima Accessoires et équipements du transporteur			
5 Proizvođač letine Document fabricant		5 a) Ime države		19 Priloge i opremljenje u vozilima Accessoires et équipements du transporteur			
6 Oznaka (broj i simbol) Marque (numéro et symbole)		7 Broj paketa Nombre des colis		8 Vrsta ambalaze Nature de l'emballage		9 Vrsta imala Designation des marchandises	
10 Oznaka (broj i simbol) Marque (numéro et symbole)		11 Bruto težina, kg Poids brut, kg		12 Zapremina u litrama Volume en litres		13 Uputstva pošiljaoca (za prenoske i druge stvari) Instructions de l'expéditeur	
14 Oznaka (broj i simbol) Marque (numéro et symbole)		15 Datum Date		20 Opis robe Description des marchandises			
21 Ispostavljen u Établi à		22		23			
24 Pošiljaoc Marchandises reçues		25		26			

Ss debelim crtama iskriveni deo mora, dopunio prevoznik: 16-18+20+23  
 Les parties encadrées de lignes grasses doivent être remplies par le transporteur: 16-18+20+23

Proučijano na odgovornost pošiljaoca od 1-15 uključno i 19+21+22  
 A remplir sous la responsabilité de l'expéditeur de 1-15 y compris la 19+21+22

\* U slučaju opreme robe upišite parcelu eventualne povrede u zadnjem redu prostora za opis pošiljke razred, valjku broj, a ako ne bude i status ADR.  
 \*\* En cas de marchandises dangereuses indiquées, cause de certification éventuelle à la dernière ligne du cadre de classe, le chiffre et le code couleur, le code ADR.

\* U slučaju opreme robe upišite parcelu eventualne povrede u zadnjem redu prostora za opis pošiljke razred, valjku broj, a ako ne bude i status ADR.  
 \*\* En cas de marchandises dangereuses indiquées, cause de certification éventuelle à la dernière ligne du cadre de classe, le chiffre et le code couleur, le code ADR.

Aneksi 5:

**Prej: 01.04.2020 deri 30.04.2020**

<b>IMPORT</b>						
			Nr. Deklaratave	Neto Kg	Vlera	
2020	IM4	XS - SËRBIA	1851	43,747,992.11	15,159,897.24	
<b>Total</b>			<b>1851</b>	<b>43,747,992.11</b>	<b>15,159,897.24</b>	

<b>EXPORT</b>						
			Nr. Deklaratave	Neto Kg	Vlera	
2020	EX1	XS - SËRBIA	140	1,827,223.55	1,116,618.73	
<b>Total</b>			<b>140</b>	<b>1,827,223.55</b>	<b>1,116,618.73</b>	

**Prej: 01.05.2020 deri 27.05.2020**

<b>IM4 - IMPORT</b>						
			Nr. Deklaratave	Neto Kg	Vlera	
2020	IM4	XS - SËRBIA	2104	39,201,549.48	15,131,365.92	
<b>Total</b>			<b>2104</b>	<b>39,201,549.48</b>	<b>15,131,365.92</b>	

<b>EXPORT</b>						
			Nr. Deklaratave	Neto Kg	Vlera	
2020	EX1	XS - SËRBIA	200	2,304,834.02	1,780,381.09	
<b>Total</b>			<b>200</b>	<b>2,304,834.02</b>	<b>1,780,381.09</b>	